



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-074

PËR BANKËN QËNDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) dhe nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila ndër të tjera, përcakton se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është një institucion i pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës; dhe

Me qëllim që të sigurohet pavarësia dhe autonomia e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,

Miraton këtë

LIGJ PËR BANKËN QËNDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Statusi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (më tutje “BQK”), pasardhëse e Autoritetit të Bankave dhe të Pagesave të Kosovës dhe e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si person juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

Në këtë ligj termat vijuese kudo që përdoren do të kenë këto kuptime:

“Bankë” do të thotë person juridik i angazhuar në veprimtarinë e pranimit të depozitave në Kosovë dhe përdorimin e këtyre fondeve plotësisht apo pjesërisht për të shtuar kredinë apo investimet për llogarinë me rrezikun e personit që ushtron veprimtarinë afariste;

“Kredi” do të thotë çdo angazhim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë për dhënien e një shume parash në këmbim të të drejtës për kthimin e shumës së dhënë dhe të papaguar dhe të pagimit të interesit apo detyrimeve të tjera mbi shumën e tillë, madje çdo shtyrje të afatit për pagimin e një borxhi, çdo garancion i dhënë për pagimin e borxhit dhe çdo angazhim për fitimin e të drejtës për pagimin e një shume parash; termi “kredi” nuk do të përfshijë depozitat bankare dhe blerjen e letrave me vlerë të borxhit në tregun dytësor;

“Letër me vlerë e borxhit” do të thotë çdo instrument i negociueshëm mbi borxhin dhe çdo instrument tjetër i barasvlershëm me instrumentin e tillë të borxhit qoftë në formë të certifikatës ose të regjistrimit;

“Institucion financiar” do të thotë një organizatë siç është banka, kompania e sigurimeve, agjenti i sigurimeve apo personi tjetër që ofron një apo më shumë nga shërbimet vijuese financiare: marrjen e depozitave; ofrimin e shërbimeve të sigurimit të të siguruarve; shtimin e kredisë; nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë; ky institucion vepron si menaxher i kompanisë për investime ose si këshilltar për investime; ofron shërbime të tjera financiare siç janë dhënia me qira e pajisjeve për shërbime financiare, fakturimin, shërbime mikrofinanciare ose këmbimin e valutave apo shërbime të tjera informative-financiare, këshillëdhënëse ose transaksionare;

“Udhëzime” do të thotë rekomandime të padetyrueshme ose deklarata të politikave të nxjerra nga BQK për informimin e institucioneve financiare dhe palëve të tjera të interesuara për punën e BQK-së;

“Kompani e sigurimeve” do të thotë personi juridik i angazhuar për ofrimin e shërbimeve të sigurimit për të siguruarit; “Agjent i sigurimeve” do të thotë agjenti i sigurimeve, nënagjenti ose ndërmjetësi qoftë i formuar si korporatë apo jo;

“Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar” do të thotë standardet ndërkombëtare më të fundit mbi raportimin financiar të nxjerra nga Bordi për standardet financiare ndërkombëtare;

“Urdhëresë” do të thotë urdhëresa detyruese e nxjerrë nga BQK-ja për zbatimin e këtij Ligji ;

“Tarifa të arsyeshme” do të thotë tarifat që mbulojnë shpenzimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta që i bën BQK-ja në ofrimin e shërbimit apo shërbimeve për të cilin është ngarkuar tarifa dhe

“Rregull” do të thotë urdhëresa obligative e nxjerrë nga BQK për zbatimin e këtij Ligji në të gjitha institucionet financiare.

Neni 3

Kompetencat e BQK

3.1 BQK-ja ka kompetenca:

- a) të lidhë kontrata, të jetë palë në procedurë ligjore dhe
- b) të marrë, të mbajë dhe të shesë pasurinë e luajtshme apo e paluajtshme për qëllimet e veprimtarisë së tij afariste.

3.2 Për qëllimet e tij zyrtare afariste BQK-ja mund të shfrytëzojë dhe të administrojë pasurinë dhe objektet, duke përfshirë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme që ndodhet në rrugën "Garibaldi" 33, në Prishtinë, Kosovë, që më herët është shfrytëzuar nga Shërbimi për Pagesat Publike në Kosovë.

Neni 4

Pushteti i përgjithshëm

4.1 BQK-ja do të ushtrojë tërë pushtetin, veçanërisht atë të dhënë me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi dhe kompetenca të tjera të rastit që me arsye janë të nevojshme për përmbushjen e kompetencave të dhëna..

4.2 BQK-ja si organ i pavarur publik do të gëzojë autonomi operationale dhe administrative dhe do të funksionojë jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës dhe shërbimit civil të Kosovës. Do të vendosë rregullat dhe procedurat e tij të brendshme me të cilat do të udhëheqë kryesisht punësimin e personelit të BQK-së, duke përfshirë stafin, këshilltarët, ekspertët dhe prokurimin, duke marrë parasysh rregullat e përgjithshme me të cilat drejtohet shërbimi publik. Asnjë person nuk do të përpiqet të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në ndonjë nga anëtarët e Bordit drejtues të BQK-së apo në punëtorët e tij gjatë kryerjes së detyrave të tyre apo të ndërhyjë në aktivitetet e BQK-së dhe asnjë nga anëtarët e Bordit drejtues të BQK-së apo punëtor i tij nuk do të bëjë përpjekje apo të veprojë në pajtim me udhëzime të tilla të gabuara gjatë përmbushjes së detyrave të tyre si anëtarë të Bordit drejtues apo si staf i BQK-së.

Neni 5

Objektivat kryesore

Objektivat kryesore të BQK-së janë:

- a) Të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta në treg dhe
- b) Pa paragjykuar këtë, të mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë në Kosovë, me synim të kontribimit në ndarjen efikase të resurseve në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur.

Neni 6

Kompetencat e veçanta

BQK-ja ka kompetencat e veçanta vijuese:

- a) t'i rekomandojë udhëzime të gjëra politike Kuvendit dhe Qeverisë në fushat që i ka në përgjegjësi;
- b) të vendosë dhe të zbatojë masat për sistemet e marrëveshjeve mbi transaksionet e valutave vendore dhe të huaja në Kosovë, të mbikëqyrë dhe të rregullojë pagesat;
- c) të posedojë dhe veprojë me një apo me më shumë sisteme pagesash;
- d) të veprojë si bankar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të ofrojë këshilla financiare me kërkesë të kësaj Ministrie;
- e) të veprojë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- f) të mbajë depozita të valutave të huaja për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe për subjektet tjera publike;
- g) të sigurojë furnizim adekuat të bankënotave dhe monedhave për rregullimin e transaksioneve me para të gatshme;
- h) të mbajë thesar për ruajtjen e sigurt të valutave dhe letrave me vlerë;
- i) të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;
- j) të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i bëjë publike rezultatet dhe t'i paraqesë propozime e masa Kuvendit dhe Qeverisë në bazë të analizave të tilla;
- k) të mbikëqyrë dhe rregullojë agjentët e shitjes në këmbimin e valutave, ndërmjetësuesit ujdisë dhe fondet e ndërsjella;
- l) të miratojë auditorët e jashtëm të institucioneve financiare;
- m) të vendosë standarde të kontabilitetit për institucionet financiare në Kosovë në harmoni me standardet ndërkombëtare financiare të raportimit..

Neni 7

Bashkëpunimi me Kuvendin dhe Qeverinë

7.1 BQK-ja do të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë dhe me subjektet e tyre përkatëse në përmbushjen e objektivave të tij.

7.2 BQK-ja do të sigurojë informacione të përgjithshme kohë pas kohe sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe subjekteve të tjera të Kuvendit dhe Qeverisë

lidhur me pagesat, veprimet bankare dhe çështjet financiare derisa informacioni nuk është i mbuluar me dispozitat mbi sekretin e veprimeve bankare dhe do të merr informacione kohë pas kohe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe subjekteve të tjera të Kuvendit dhe Qeverisë, sipas kërkesës së BQK-së lidhur me çështjet makro-ekonomike dhe financiare.

Neni 8 **Bashkëpunimi teknik**

8.1 BQK-ja mund të marrë pjesë në mbledhje dhe takime pune të institucioneve financiare ndërkombëtare, të organizatave dhe të këshillave që janë në fushën e kompetencave të tij, dhe nëse është e duhur mund të kërkojë edhe anëtarësim në to.

8.2 BQK-ja mund të ofrojë shërbime të veprimeve bankare dhe të pagesave në dobi të qeverive të huaja, bankave të huaja, autoriteteve të jashtme monetare dhe të organizatave ndërkombëtare publike dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare në bazë të interesave të ndërsjella.

Neni 9 **Informimi publik**

9.1 BQK-ja do të informojë rregullisht dhe me kohë publikun Kuvendin dhe Qeverinë mbi analizat e tij makro-ekonomike dhe zhvillimet në tregun financiar si dhe mbi informacionet e përafërta statistikore.

9.2 Guvernatori i BQK-së së paku një herë në vit do t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës raport gjithëpërfshirës mbi gjendjen në sektorin financiar të Kosovës.

Neni 10 **Zyra e BQK-së**

Zyra e BQK-së është në Prishtinë dhe nuk do të ketë degë.

Neni 11 **Llogaritë**

11.1 BQK-ja mund të hapë llogari në librat e tij vetëm në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të subjekteve të Qeverisë, të agjencive publike, të institucioneve financiare që veprojnë legalisht në Kosovë, të bankave të huaja, të institucioneve financiare ndërkombëtare publike dhe organizatave të donatorëve. BQK-ja nuk do të hapë llogari për personat fizikë apo për ndërmarrjet private. Për ndërmarrjet publike dhe subjektet mund të hapen llogari në bazë të autorizimit special të Bordit drejtues, të dhënë për secilin rast veç e veç, me qëllim të

përfitimit publik, në pajtim të plotë me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

11.2 Gjithë pasivet e llogarisë depozitë të BQK-së do të kenë aktivet korresponduese ashtu siç parashihet në nenin 48 të këtij ligji.

DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 12 Kapitali

12.1 Kapitali i autorizuar i BQK-së do të jetë tridhjetë (30) milion euro. Për pasojë, kapitali dhe llogaritë e rezervave të përgjithshme do të jenë së paku të barasvlershme me pesë për qind të shumës së përgjithshme të bilancit të kredive të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BQK-së nga mbajtësit e llogarive të paraqitura në bilancin e BQK-së në fund të çdo viti financiar. Kapitali mund të rritet nga shumat e tilla ashtu siç mund të përcaktohet nga Bordi drejtues i BQK-së dhe të miratohet nga Qeveria. Kapitali i BQK-së nuk i nënshtrohet hipotekës.

12.2 Kapitali nuk do të zvogëlohet përveç me shpalljen e ndonjë legjislacioni të miratuar nga Kuvendi.

12.3 Kurdo që:

a) në bilancin formal mujor të BQK-së vlera e aktivitet (pasurisë) bie nën shumën e pasivit dhe kapitalin e padëmtuar të autorizuar të tij ose,

b) fitimi neto i BQK-së për cilindo vit financiar është i pamjaftueshëm për të rritur kapitalin dhe llogaritë e rezervave të përgjithshme të BQK-së në nivel të barasvlershëm me pesë për qind të shumës së përgjithshme të bilancit të kredive të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BQK-së nga mbajtësit e llogarive, të paraqitura në bilancin e BQK-së në fund të atij viti financiar, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, brenda një muaji pas shpalljes së atij bilanci, i ofron një ndihmesë të rëndësishme BQK-së në shumën apo shumat e nevojshme për kompensimin e këtij deficiti.

Neni 13 Përcaktimi dhe ndarja e të ardhurave

13.1 Për çdo vit financiar të ardhurat neto ose humbjet neto të BQK-së llogariten në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit financiar dhe raportimit.

13.2 Të ardhurat neto do të ndahen çdo vit në llogarinë e rezervave të përgjithshme derisa kapitali dhe llogaritë e rezervave të përgjithshme të jenë të njëjta me pesë për qind të shumës së përgjithshme të bilancit të kredive të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BQK-së nga mbajtësit e llogarive, të paraqitura në bilancin e BQK-së në fund të çdo viti financiar.

13.3 Çdo bilanc i të ardhurave të realizuara neto do të transferohet në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave si të ardhura për buxhetin.

13.4 Nëse ka humbje neto, këto do të mbulohen nga llogaria e rezervës së përgjithshme ose nga kapitali, sipas kësaj radhe.

Neni 14 Buxheti vjetor

14.1 Të gjitha shpenzimet materiale të propozuara të BQK-së duhet raportuar në buxhetin vjetor, i cili duhet të miratohet nga Bordi drejtues. Shpenzimet e BQK-së nuk i nënshtrohen kontrolleve buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, por do të përcaktohen përmes buxhetit të BQK-së. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do t'i transferojë cilatdo fonde të përvetësuara në mënyrë adekuate BQK-së për përdorim, të kërkuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në fillim të çdo viti, sipas politikave dhe procedurave të BQK-së.

14.2 Buxheti vjetor i BQK-së do të përgatitet ashtu që të përkojë me planin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. BQK-ja do ta informojë në tërësi Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për planet e tij buxhetore.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 15 Organizimi i BQK-së

BQK-ja do të ketë Bordin drejtues, menaxhmentin dhe stafin.

Neni 16 Bordi Drejtues

16.1 Bordi drejtues do të krijojë politikat për punën e BQK-së dhe do të mbikëqyrë zbatimin e tyre.

16.2 Menaxhmenti i BQK-së i raporton jo më pak se dhjetë herë çdo vit Bordit drejtues lidhur me drejtimin e punëve dhe politikave, mbi saktësinë e sistemit financiar dhe mbi gjendjen e parave, të kapitalit dhe tregjet e këmbimit të valutave duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe kushtet të cilat kanë ose pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në administrimin o punën e BQK-së apo në drejtimin e politikave të tij a të sistemit financiar apo në tregjet e sipërpërmendura dhe në çfarëdo çështje tjetër që ndikon o ka gjasa të ndikojë në politikat e BQK-së.

Neni 17

Kompetencat e Bordit drejtues

Bordi drejtues ka kompetencat e mëposhtme:

- a) të miratojë politikat për përmbushjen e kompetencave të BQK-së të paraqitura në nenin 6 dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre nga menaxhmenti dhe stafi;
- b) të miratojë të gjitha rregullat, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga BQK-ja;
- c) të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BQK-ja ia paraqet Kuvendit dhe Qeverisë;
- d) bordi cakton me vendim së paku dy drejtorë joekzekutiv në përbërjen e Komisionit të revizionit;
- e) të miratojë organizimin e BQK-së;
- f) të caktojë dy Zëvendës Guvernatorë me propozim të Guvernatorit për mandat deri në pesë vite;
- g) të miratojë caktimin e inspektorit të përgjithshëm të BQK-së për mandat deri në pesë vite;
- h) të miratojë buxhetin e BQK-së;
- i) të miratojë politikat e kontabilitetit të BQK-së dhe raportet periodike bashkë me gjendjen financiare të BQK-së;
- j) të vendosë për borxhet e BQK-së në shuma materiale, për afatet dhe kushtet e këtij borxhi;
- k) të miratojë kategoritë e të hyrave që do të jenë të përshtatshme për investime të resurseve financiare të BQK-së;
- l) të miratojë apo refuzojë kërkesat për licencë apo regjistrim të institucionit financiar dhe të anulojë licencën ose regjistrimin e institucionit financiar;
- m) të miratojë strukturat, politikat dhe procedurat e brendshme për licencim, regjistrim, mbikëqyrje dhe rregullim financiar duke përfshirë edhe kompetencat që i delegohen stafit të BQK-së për ndërmarrjen e veprimeve korrektuese; dhe
- n) të miratojë para zbatimit të tyre të gjitha masat detyruese të përgatitura nga stafi i BQK-së, me përjashtim të atyre që veçanërisht janë në kompetencë të Guvernatorit, të shënuar në nenin 29.4 të këtij Ligji .

Neni 18

Përbërja e Bordit Drejtues

18.1 Bordi drejtues përbëhet nga pesë anëtarë: katër drejtorë jo-ekzekutivë dhe Guvernatori. Drejtori i Thesarit është një nga Drejtorët jo-ekzekutivë. Tre Drejtorët e tjerë jo-ekzekutivë dhe Guvernatori emërohen ashtu si parashikohet nga neni 18.2 i këtij ligji.

18.2 a) Bordi Drejtues fillimisht nominon kandidatët. Aktet e tij nën-ligjore përcaktojnë procesin e hapur, të paanshëm dhe transparent të zgjedhjes dhe intervistimit për kandidatët.

Bordi Drejtues nuk do të konsiderojë më pak se dy kandidatë për secilën pozitë dhe mund të propozojë më tepër se një të nominuar për secilën pozitë. Në të tilla raste, Bordi i rendit të nominuarit në bazë të kualifikimeve dhe performancës së tyre gjatë intervistave dhe jep shpjegime për këtë renditje.

b) bordi i paraqit nominimet e bëra sipas pikës (a) për miratim në Kuvend.

c) pas miratimit nga Kuvendi, nominimet dërgohen për emërim te Presidenti. Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, emërimi i Guvernatorit sipas nenit 18.1 të këtij ligji bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil.

18.3 Kryesuesi do të zgjidhet nga Bordi drejtues që do të jetë njëri nga tre Drejtorët tjerë jo-ekzekutivë dhe do të shërbejë si Kryesues i Bordit Drejtues.

18.4 Dy Zëvendës Guvernatorët mund të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit drejtues si vëzhgues.

18.5 Anëtarët e Bordit drejtues, përveç, duhet të jenë persona me figurë të pastër morale dhe me arsim të lartë profesional si dhe me përvojë në çështjet financiare, bankare ose ligjore por pa mandate politike aktuale apo mandat që ka zgjatur më pak se një vit.

18.6 Mandati i çdo anëtari të Bordit drejtues është pesë vjet. Anëtarët e Bordit drejtues kanë të drejtë në riemërim vetëm edhe për një mandat tjetër pesëvjeçar.

Neni 19

Kompensimi i anëtarëve të Bordit drejtues

19.1 Anëtarët e Bordit drejtues do të kompensohen nga BQK-ja në formë të tarifave të mbledhjeve, të ngjashme me ato që i marrin personat që mbajnë poste ekzekutive dhe joekzekutive në bordet mbikëqyrëse apo menaxhuese, varësisht nga rasti në institucionet e mëdha financiare në rajon.

19.2 Asnjë anëtar i Bordit drejtues i financuar nga organizatat ndërkombëtare nuk do të marrë kompensim bazuar vetëm në cilësinë e tyre si anëtar i Bordit drejtues.

19.3 Kompensimet e marra apo mospranimet e kompensimeve të tilla nga anëtarët e Bordit drejtues lidhur me shërbimin e tyre në BQK, përveç atyre të cekura më lart, do t'i shpalosen me shkrim Kuvendit

Neni 20

Mospasja të drejtë për të shërbyer në Bordin drejtues

a) asnjë person nuk do të shërbejë në Bordin drejtues derisa ai të jetë zyrtar apo punonjës i një institucioni financiar që vepron përmes zyrave në Kosovë apo që është pronar i përfitimit prej pesë për qind a më shumë të interesit të ekuitetit në një institucion financiar që vepron në Kosovë.

b) asnjë person, përveç drejtorit të thesarit, nuk do të shërbejë në Bordin drejtues derisa ai mban post publik apo është nëpunës civil, por ky skualifikim nuk zbatohet për stafin e institucioneve akademike dhe kërkimore.

c) çdo anëtar i Bordit drejtues gjithashtu do të plotësojë çdo kërkesë tjetër të përcaktuar nga BQK-ja për anëtarët e bordeve të bankave, përveç rasteve kur kjo nuk do të ishte në harmoni me këtë ligj.

Neni 21

Shkarkimi i anëtarëve të Bordit drejtues

21.1 Çdo anëtar i Bordit drejtues shkarkohet nga Bordi, apo nga Kuvendi kur këtë nuk e bën Bordi nëse ai ose ajo:

- a) nuk ka të drejtë të shërbejë në Bordin drejtues sipas nenit 20 të këtij ligji.;
- b) është dënuar për kundërvajtje për të cilën shqiptohet dënim me burgim pa mundësi të shqiptimit të gjobës;
- c) është përfshirë si debitor në procedurë të bankrotimit apo falimentimit;
- d) për shkak të keqsjelljeve personale është skualifikuar apo suspenduar nga ushtrimi i profesionit nga autoriteti kompetent ose
- e) nga shumica e anëtarëve të Bordit drejtues është konstatuar se është përgjegjës për angazhim në veprimtari që nuk janë në përputhje me standardet dhe ndershmërinë ose është i papërshtatshëm për anëtar të Bordit drejtues.

21.2 Përveç dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, çdo anëtar i Bordit drejtues mund të shkarkohet nga Bordi ose Kuvendi nëse Bordi nuk e shkarkon pas konstatimit dhe rekomandimit nga shumica e anëtarëve të Bordit drejtues se anëtari:

- a) është i paaftë për të kryer funksionet e postit të tillë për shkak të një sëmundje trupore apo mendore që ka zgjatur më shumë se dy muaj ose
- b) ka munguar në tri mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit drejtues pa arsye të justifikueshme sipas mendimit të Bordit drejtues

Neni 22

Dorëheqja

Anëtarët e Bordit drejtues mund të japin dorëheqje duke e njoftuar me shkrim në afat jo më pak se një muaj Kryesuesin e Bordit të BQK dhe Kryetarin e Kuvendit.

Neni 23

Postet e lira në Bordin drejtues

Çdo post i lirë në Bordin drejtues do të plotësohet brenda një periudhe maksimale prej gjashtë muajsh me emërimin e një anëtari të ri në Bordin drejtues, në pajtim me nenin 18.

Neni 24

Mbledhjet e Bordit drejtues

24.1 Dy Zëvendës Guvernatorët mund të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit drejtues si vëzhgues. Ata nuk kanë të drejtë vote.

24.2 Mbledhjet e Bordit drejtues do të kryesohen nga kryesuesi apo në mungesë të tij nga Guvernatori; nëse mungon edhe Guvernatori mbledhja do të kryesohet nga njëri prej zëvendës Guvernatorëve, sipas nenit 29.5 të këtij ligji..

24.3 Bordi drejtues do të takohet aq herë sa do të kërkohet nga veprimtaria afariste e BQK-së, por jo më pak se dhjetë herë në vit.

24.4 Pas konsultimeve të rregullta me Guvernatorin, mbledhjet e Bordit drejtues konvokohen nga kryesuesi i cili vendos për rendin e ditës pas propozimit të Guvernatorit; mbledhjet mund të konvokohen edhe me kërkesë të cilitdo nga dy anëtarë të Bordit drejtues.

24.5 Mbledhjet e Bordit drejtues konvokohen duke i njoftuar të gjithë anëtarët e Bordit drejtues për kohën, vendin dhe rendin e ditës së paku pesë ditë pune para datës së caktuar për mbledhjen; në rast të ndonjë urgjence, mbledhjet mund të konvokohen edhe me njoftim pak para mbajtjes së mbledhjes.

24.6 Çdo anëtar i Bordit drejtues ka një votë. Në rast të barazimit, kryesuesi e hedh votën për prishjen e barazisë.

24.7 Në çdo mbledhje të Bordit drejtues kërkohet pjesëmarrja e Guvernatorit apo, në mungesë të tij apo saj, Zëvendës Guvernatorit që e zëvendëson atë në pajtim me nenin 29.6 të këtij ligji..

24.8 Kuorumi për kryerjen e punëve dhe marrjen e vendimeve në çdo mbledhje të Bordit drejtues përbëhet nga tre anëtarë të Bordit drejtues.

24.9 Përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe, vendimet e Bordit drejtues do të miratohen me shumicën e thjeshtë të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë; mirëpo lejohen mbledhjet dhe votimi me telekonferencë.

24.10 Duke iu nënshtruar kërkesave për kuorum në paragrafin 8 të këtij neni, asnjë akt apo procedurë e Bordit drejtues nuk do të shfuqizohet thjeshtë për shkak të ndonjë boshllëku apo boshllëqeve në Bordin drejtues.

24.11 Të gjitha veprimet e ndërmarra nga një person në mirëbesim si anëtar i Bordit drejtues janë valide, pavarësisht se më vonë zbulohet ndonjë e metë në emërimin, të drejtën ose kualifikimin e atij personi.

Neni 25

Procedura e mbledhjeve të Bordit drejtues

25.1 Procedura e mbledhjeve të Bordit drejtues është konfidenciale. Bordi drejtues mund të vendosë që rezultatin e bisedimeve për çdo çështje ta bëjë publike dhe menjëherë t'i publikojë vendimet e tij mbi çështjet e politikave të përgjithshme. Anëtar i cili është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ku ndërmirren veprime për çfarëdo çështjesh, konsiderohet se pajtohet me veprimin e ndërmarrë përveç nëse mospajtimi i tij përfshihet në procesverbalin e mbledhjes apo nëse ai mospajtimin e tij ia paraqet me shkrim personit që ushtron detyrën e sekretarit të mbledhjes para përfundimit të takimit.

25.2 Procesverbali i çdo mbledhjeje të Bordit drejtues nënshkruhet nga Guvernatori i BQK-së apo nga zëvendës Guvernatori që shërben përkohësisht si zyrtar kryesues, nga kryesuesi dhe nga sekretari i Bordit drejtues.

25.3 Sekretari i Bordit drejtues caktohet nga Guvernatori në konsultim me kryesuesin nga stafi i lartë i BQK-së për të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit dhe për të mbajtur të gjitha shënimet e BQK-së. Sekretari nuk është anëtar i Bordit drejtues.

Neni 26

Deklarimi i interesave financiare nga anëtarët e Bordit drejtues; Detyrat fiduciare

26.1 Anëtarët e Bordit drejtues herë pas herë do t'i deklarojnë Bordit drejtues në tërësi interesat e tyre të rëndësishme financiare të cilat ata apo pjesëtarët e familjeve të tyre drejtpërsëdrejti apo tërthorazi mund t'i kenë; deklarimet e tilla janë në pajtim me udhëzimet e miratuara nga Bordi drejtues.

26.2 Çdoherë kur ndonjë çështje e lidhur me interesin e tillë paraqitet pranë Bordit drejtues, anëtar i cili deklaron interesin e tij në fillim të diskutimit dhe nuk merr pjesë në diskutim dhe vendim mbi çështjen e tillë; mospjesëmarrja e atij anëtar i cili për shkak të konfliktit të interesit do të shënohet në procesverbal.

26.3 Anëtarët e Bordit drejtues dhe punonjësit e BQK-së kanë detyrë fiduciare (në mirëbesim) ndaj BQK-së dhe klientëve të BQK-së që interesat e BQK-së dhe interesat e klientëve të tij t'i vënë para interesit të tyre monetar.

Neni 27
Shërbimi i mëpastajmë

Ish-anëtarët e Bordit drejtues nuk do të shërbejnë në detyra profesionale menaxheriale në ndonjë institucion financiar që vepron në Kosovë gjatë një periudhe njëvjeçare menjëherë pas largimit të tyre nga BQK-ja.

Neni 28
Përbërja e menaxhmentit të BQK-së

Menaxhmenti i BQK-së përbëhet nga Guvernatori i cili është kryeshefi ekzekutiv dhe nga dy Zëvendës Guvernatorët .

Neni 29
Menaxhmenti i BQK-së

29.1 Guvernatori është përgjegjës për zbatimin e politikave të miratuara nga Bordi dhe drejtimin e menaxhimit në planifikimin e tij strategjik dhe përmbushjen e objektivave kryesore të BQK-së të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji..

29.2 Guvernatori i përgjigjet Bordit drejtues për ekzekutimin e vendimeve të tij dhe për drejtimin e kontrollimin e administrimit dhe punën e BQK-së.

29.3 Të gjitha kompetencat të cilat nuk i janë rezervuar në mënyrë të veçantë Bordit drejtues do t'i ngarkohen Guvernatorit. Në kuadër të kompetencave të tij të kufizuara, Guvernatori ka kompetencë që të ndërmerr të gjitha veprimet e kërkuara apo që konsiderohen të rekomandueshme për administrimin ose punën e BQK-së, duke përfshirë, pa kufizime, angazhimet kontraktuese në emër të BQK-së, caktimin e punonjësve, të agjentëve dhe korresponduesve të BQK-së dhe përgjithësisht të përfaqësojë BQK-në. Me miratimin e Bordit drejtues, Guvernatori mund t'ua delegojë disa nga kompetencat e tij punonjësve të tjerë të BQK-së.

29.4 Me kusht që ato t'i raportohen rregullisht Bordit, Guvernatori drejtpërsëdrejti ndërmerr veprimet vijuese ekzekutive:

- (i) nxjerrjen e paralajmërimeve me shkrim,
- (ii) nxjerrjen e urdhrave me shkrim për pushimin dhe ndërprerjen e shkeljeve të Ligjit të BQK-së dhe të çfarëdo rregulle apo urdhri tjetër apo legjislacion tjetër në fuqi mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese,
- (iii) shqiptimin e gjobave në shumën deri në 10.000 euro,
- (iv) nxjerrjen e urdhrave me shkrim për shqiptimin e masave për rikthimin e gjendjes së shëndoshë financiare.

29.5 Zëvendës Guvernatorët i përcjellin dhe i mbikëqyrin aktivitetet e BQK-së sipas përcaktimeve të Guvernatorit dhe i përgjigjen Guvernatorit.

29.6 Në mungesë të Guvernatorit në mbledhjet e Këshillit drejtues dhe kur Guvernatori nuk është në zyrë, njëri nga Zëvendës Guvernatorët, sipas renditjes së përcaktuar nga Guvernatori, e zëvendëson Guvernatorin dhe i merr përgjegjësitë e tij për t'i zbatuar sipas udhëzimeve të Guvernatorit apo, nëse është udhëzuar ashtu, sipas gjykimit të tij.

Neni 30 **Inspektori i përgjithshëm i BQK-së**

30.1 Inspektori i përgjithshëm i BQK-së emërohet nga Guvernatori me miratimin e Këshillit drejtues. Inspektori i përgjithshëm duhet t'i ketë kualifikimet e kërkuara për të shërbyer si anëtar i Këshillit drejtues.

30.2 Inspektori i përgjithshëm mund të japë dorëheqje duke e paralajmëruar për këtë Guvernatorin jo më pak se dy muaj para dorëheqjes. Inspektori i përgjithshëm largohet nga posti vetëm përmes vendimit të Këshillit drejtues, nëse vendimi i tillë bazohet në një apo më shumë arsye për largim të cekura në nenin 21.

30.3 Detyrat e inspektorit të përgjithshëm janë:

- a) vlerësimi i cilësisë së sistemeve ekzistuese dhe të atyre të propozuara të menaxhimit si dhe atyre të kontrollit financiar;
- b) vlerësimi i punës së atyre sistemeve dhe i besueshmërisë e integritetit të informatave dhe transaksioneve të bëra;
- c) vlerësimi i përshtatshmërisë së kontrolleve për ruajtjen e aktivës së BQK-së dhe, sipas nevojës, vërtetimin e ekzistimit të aktivës;
- d) vlerësimi i përputhjes me ligje, akte nën-ligjore, rregulla, urdhra dhe me politika me të cilat udhëhiqen punët e BQK-së;
- e) zbatimimi i rishikimeve të përdorimit të efektshëm dhe të përpiktë të burimeve të BQK-së dhe dhënia e rekomandimeve të duhura menaxhmentit dhe
- f) zbatimimi i rishikimeve të posaçme me kërkesë të menaxhmentit dhe bashkëpunimi me kontrolluesit financiarë të BQK-së.

30.4 Inspektori i përgjithshëm ofron përmbledhjen e konkludimeve dhe sugjerimeve të tij në raportet që i paraqiten çdo gjashtë muaj Komisionit për kontroll financiar brenda Këshillit drejtues, i cili përbëhet prej së paku 2 anëtarëve joekzekutivë. Përveç kësaj, inspektori i përgjithshëm i raporton Komisionit për kontroll financiar kurdo që ai mendon se Komisioni duhet të informohet.

Neni 31

Personeli i BQK-së

31.1 Personeli i BQK-së nuk mund të jetë i punësuar nga çfarëdo institucioni a personi tjetër pos BQK-së, përveç nëse Këshilli drejtues shprehimisht vendos ndryshe në rastet kur ka arsyetim.

31.2 Këshilli drejtues i miraton afatet dhe kushtet e punësimit të cilat përfshijnë dispozitat për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 32

Punonjësit, agjentët dhe bashkëpunëtorët e BQK-së

32.1 Guvernatori i lëshon dhe i përfundon kontratat e punonjësve, agjentëve dhe bashkëpunëtorëve të BQK-së në përputhje me afatet dhe kushtet e punësimit të miratuara nga Këshilli drejtues.

32.2 Asnjë pagë, honorar, mëditje apo pagesë tjetër e BQK-së nuk do të llogaritet përmes referimit në të hyra neto, fitime neto apo të hyra të tjera të BQK-së.

Neni 33

Konflikti i interesave

33.1 Menaxhmenti dhe inspektori i përgjithshëm do t'ia përkushtojnë të gjitha shërbimet e tyre profesionale BQK-së dhe nuk do të kenë ndonjë post a punësim tjetër me pagesë apo pa të, përveç në cilësinë e të emëruarit të BQK-së dhe në angazhime të llojit edukativo-arsimor e civil të rastit.

33.2 Asnjë anëtar i Këshillit drejtues apo punonjës tjetër i BQK-së nuk mund të marrë ndonjë dhuratë apo meritë në emër të cilitdo personi me të cilin ka lidhje familjare, afariste apo financiare, nëse pranimi i tyre do të rezultonte në humbjen e përkushtimit të paanshëm ndaj detyrave të tij në BQK.

Neni 34

Fshehtësia

34.1 Asnjë person që punon apo që ka punuar si anëtar i Këshillit drejtues, si punonjës apo si kontrollues financiar, agjent a bashkëpunëtor i BQK-së nuk mund të lejojë që në mënyrë të paautorizuar sipas këtij Ligji të bëhet qasja, prezantimi apo publikimi i materialeve jopublike informative që janë marrë gjatë kryerjes së detyrave të BQK-së apo që të përdoret ajo informatë ose të lejojë që ajo informatë të përdoret për përfitime personale.

34.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, personat e tillë mund të paraqesin informata jopublike materiale jashtë BQK-së në përputhje me procedurat e parapara nga BQK-ja vetëm:

- a) nëse janë në përputhje me pëlqimin gojor apo të nënkuptuar të personit me të cilin informata ka të bëjë;
- b) nëse paraqiten në kuadër të përmbushjes së obligimeve ndaj qytetarëve, duke përfshirë në kuadër të ndihmesës për organet e zbatimit të ligjit dhe sipas urdhrat të gjykatës apo të personit tjetër kompetent;
- c) nëse u jepen kontrolluesve financiarë të BQK-së;
- d) nëse u jepen autoriteteve mbikëqyrëse të institucioneve financiare dhe punonjësve të institucioneve publike financiare ndërkombëtare gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare;
- e) nëse interesat e vetë BQK-së gjatë procedurave gjyqësore kërkojnë paraqitjen e informatave apo
- f) nëse Këshilli drejtues ka dhënë pëlqimin e vet.

Neni 35

Bankieri, këshilltari financiar dhe agjenti fiskal

35.1 BQK-ja në cilësinë e bankierit, të këshilltarit dhe të agjentit fiskal të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të subjekteve të tjera të Qeverisë siguron që asnjë transaksion i bërë nga BQK-ja të mos shërbejë për favore apo përfitime të ndonjë autoriteti publik ose të ndonjë subjekti tjetër fizik apo juridik.

35.2 BQK-ja ka për detyrë t'i jep këshilla Qeverisë si dhe Kuvendit për çështjet e rëndësishme financiare që kanë të bëjnë me objektivat e BQK ose që janë në kuadër të kompetencave të tij.

35.3 BQK konsultohet me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave me rastin e hartimit të buxhetit.

Neni 36

Depozituesi dhe arkëtari

BQK-ja mund të pranojë depozita në çdo valutë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe nga subjekte të tjera publike. Si depozitar, BQK-ja pranon dhe jep të holla, mban llogarinë për to dhe ofron shërbime të tjera financiare lidhur me to. BQK-ja paguan në kufijtë e shumave të depozituara në bazë të urdhërpagesave për llogaritë përkatëse. BQK-ja paguan kamatë për depozita të tilla sipas përqindjes së tregut të dhënë nga banka qendrore për atë valutë. Shkalla e kamatës e paguar nga BQK-ja për organizatat e tilla nuk i tejkalon ato të bankës emetuese.

Neni 37
Funksioni i agjencisë fiskale

BQK-ja mund të vepron si agjent fiskal sipas afateve dhe kushteve të pajtuara me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe për llogari të kësaj ministrie dhe agjencive e instrumenteve të saj që mund të përcaktohen nga Qeveria.

Neni 38
Informata që duhet t'i jepet BQK-së

BQK-ja merr nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe nga subjektet e tjera të Qeverisë të gjitha informatat ekonomike e financiare dhe dokumentet që BQK-ja i kërkon për kryerjen e funksioneve të tij.

**MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET FINANCIARE DHE FUNKSIONET E
SISTEMIT TË PAGESAVE**

Neni 39
Pagesat, kliringu dhe shlyerja e detyrimeve

Në përputhje me objektivat kryesore dhe me pushtetin specifik të BQK-së në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji., BQK-ja mund të organizojë, të jetë në pronësi, të punojë dhe të mbikëqyrë e rregullojë sistemet për urdhërpagesat dhe për shlyerjen e pagesave ndërbankare në valutat e caktuara, me ose pa prerje ligjore për pagesa, duke përfshirë pagesat me anë të çekut dhe instrumenteve të tjera të pagesave, si dhe përcakton procedura, nxjerrë rregulla e urdhëresa që konsiderohen si të përshtatshme lidhur me to.

Neni 40
Llogaritë e bankave në librat e BQK-së

Çdo bankë që vepron në Kosovë dhe që dëshiron të marrë pjesë në sistemin e pagesave, në kliring dhe në sistemin për shlyerjen e detyrimeve duhet të hapë dhe të mbajë një llogari në librat e BQK-së sipas afateve dhe kushteve të caktuara nga BQK-ja dhe duhet t'i japë menjëherë BQK-së informacionin e kërkuar lidhur me kushtet e punës dhe ato financiare që BQK-ja mund t'i përcaktojë me rregulla të tij.

Neni 41

Rrjeti i informacioneve

BQK-ja mund të krijojë dhe të mirëmbajë një rrjet informacioni për sistemin financiar të Kosovës.

Neni 42

Mbikëqyrja dhe rregullimi i institucionit financiar

BQK-ja është i vetmi organ përgjegjës për licencimin e institucioneve financiare në Kosovë dhe për mbikëqyrjen e rregullimin e tyre dhe është e autorizuar:

- a) për nxjerrjen e rregullave, urdhëresave dhe udhëzimeve dhe për ndërmarrjen e veprimeve të tjera, duke përfshirë marrjen e licencave të institucioneve financiare dhe vënien nën kontroll të institucionit të falimentuar financiar, për të cilin kjo konsiderohet e nevojshme apo e këshillueshme, në mënyrë që t'i përmbarojë kompetencat dhe përgjegjësitë e veta sipas këtij ligji dhe sipas ligjeve të tjera në fuqi;
- b) për inicimin e kontroleve nga nëpunësit e tij apo nga ndonjë person tjetër i kualifikuar i caktuar për këtë qëllim në çdo bankë me qëllim të kontrollimit të librave, regjistrimeve, dokumenteve dhe të llogarive të çfarëdo institucioni financiar me qëllim të vërtetimit të kushteve të afarizmit dhe të përputhjes me këtë Rregullore apo me cilëndo rregull a urdhër dhe ligj tjetër në fuqi mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare;
- c) për të kërkuar nga drejtori, zyrtari apo nëpunësi i institucionit financiar dhënien e informatave të kërkuara nga BQK-ja me qëllim të mundësisimit të BQK-së që të mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare dhe
- d) të kërkoj nga çdo institucion financiar ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese apo që të shqiptojë dënime të parapara me këtë ligj a me çdo rregull o urdhër tjetër ose legjislacion në fuqi mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, nëse ka pasur shkelje nga institucioni financiar apo nga një a më shumë zyrtarë a drejtorë të tij, të këtij ligji ose të çfarëdo rregulle a urdhri ose ndonjë legjislacioni tjetër në fuqi a urdhërese të BQK-së, apo shkelje të çfarëdo kushti a kufizimi të bashkëngjitur ndonjë autorizimi apo miratimi të lëshuar nga BQK-ja për ndonjë institucion financiar, të shkeljes së ndonjë rregulli a urdhërese të nxjerrë nga BQK-ja, apo në rast të kushteve të pasigurta dhe jo të shëndosha a veprimeve nga institucioni financiar.
- e) mbikëqyrja e grupeve financiare në bazë të qasjes së konsoliduar, ku përfshihet mbikëqyrja e të gjitha aktiviteteve të grupit.

Neni 43

Respektimi i rregullave dhe urdhëresave

43.1 Çdo institucion financiar duhet të veprojë në përputhje me rregullat dhe urdhëresat e BQK-së lidhur me: llogaritë e bilancit, zotimet jashtë bilancit, deklaratat e të hyrave dhe shpenzimeve në lidhje me raportet ndërmjet llogarive a zërave e ndalimeve, kufizimet ose

kushtet për lloje a forma specifike të kredive a investimeve, kreditë ose investimeve që tejkalojnë një shumë të caktuar ose format e angazhimeve me rrezikshmëri, kontrollin e maturimit të aktivave dhe pasivave dhe zërave jashtë bilancit apo pozicionin e hapur valutor, këmbimin, opcionet ose lidhur me pozitat e ngjashme apo qasjen në sistemin e pagesave.

43.2 Institucionet financiare që angazhohen në aktivitete të ngjashme dhe që janë në gjendje të krahasueshme financiare duhet t'u përmbahen gjithashtu këtyre rregullave dhe urdhëresave.

Neni 44 **Dorëzimi i informacionit në BQK**

44.1 Institucionet financiare duhet t'i japin BQK-së informacionin lidhur me aktivitetin dhe gjendjen financiare të tyre sipas kërkesës së BQK-së.

44.2 BQK-ja mund t'i botojë këto informacione dhe të dhëna plotësisht ose pjesërisht në formë të përmbledhur për llojet e institucioneve financiare sipas natyrës së aktivitetit të tyre.

44.3 Institucioni financiar publikon pasqyra periodike të kontabilitetit vetëm në bazë të modeleve dhe standardeve të përcaktuara nga BQK-ja në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

RREGULLIMI DHE FUNKSIONIMI I KËMBIMIT VALUTOR

Neni 45 **Tregtarët e këmbimit valutor**

BQK-ja është e autorizuar:

- a) të nxjerrë rregulla dhe urdhëresa për administrimin e transaksioneve të këmbimit valutor për individë, ndërmarrje jofinanciare, institucione financiare e për agjenci dhe instrumente të ndryshme të themeluara në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë;
- b) të jep licenca, të mbikëqyrë dhe të rregullojë tregtarët e këmbimit valutor, duke përfshirë këtu edhe bankat;
- c) të përcaktojë kufijtë e pozicioneve të këmbimit të valutave për tregtarët e këmbimit valutor, duke përfshirë këtu edhe bankat dhe
- e) të përcaktojë metodat për përcaktimin e vlerës së valutave ndaj valutave të tjera.

Neni 46
Raportimi i transaksioneve të këmbimit valutor

BQK-ja mund të kërkojë nga tregtarët e licencuar të këmbimit valutor duke përfshirë këtu edhe bankat, të raportojnë periodikisht për veprimtarinë e tyre duke përfshirë pozicionet e tyre të hapura valutore për çdo valutë; BQK-ja përcakton formularët për raportimin e dokumenteve të tjera përcjellëse që duhet të dorëzohen.

Neni 47
Veprimet në këmbimin valutor

BQK-ja mund:

- a) të blejë, të shesë ose të veprojë me monedha a shufra ari por edhe me metale të tjera të çmueshme;
- b) të blejë, të shesë dhe të veprojë në këmbimin valutor duke përdorur për këto qëllime aktivet e përshkruara në nenin 48 dhe
- c) të përcaktojë kursin e blerjes, të shitjes apo të veprimit me valuta të huaja.

Neni 48
Aktivët në këmbimin valutor

48.1 BQK-ja mban bilancin e saj dhe administron aktivat në valutë të huaj që përbëhen nga një apo nga të gjitha aktivat e mëposhtme:

- a) ari;
- b) valuta e huaj në formë të bankënotave dhe monedhave që mbahen në Kosovë apo në llogaritë bankare të mbajtura jashtë vendit në valutë të huaj në banka, pasivet afatshkurtra të cilave klasifikohen në një nga dy kategoritë më të larta të agjencive të pranuar ndërkombëtarisht për klasifikimin e kredive dhe
- c) letrat me vlerë të lëshuara a të garantuara nga shtetet apo bankat qendrore të Bashkimit Evropian me afat maksimal maturimi prej një viti, të cilat përcaktohen dhe paguhet në euro.

48.2 Synimet kryesore në zgjedhjen e aktiveve në valutë të huaj janë siguria e kapitalit dhe likuiditeti. Në varësi të këtyre synimeve, këto aktive zgjedhen për të rritur fitimet.

Neni 49
Marrëveshjet e kliringut dhe të pagesave

BQK-ja, për llogari të veten apo për llogari dhe me urdhër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave mund të hyjë në marrëveshje kliringu dhe të pagesave ose në çfarëdo kontrate tjetër për të njëjtin qëllim me institucionet qendrore të kliringut publik dhe privat me seli jashtë vendit.

ADMINISTRIMI ME VALUTA

Neni 50
Ruajtja e valutave

BQK-ja u jep institucioneve financiare dhe publikut objekte për ruajtjen e bankënotave dhe monedhave në valutat që i përcakton.

Neni 51
Rezervat në valutë

BQK-ja administron një rezervë valutore në valutën që e konsideron të përshtatshme për pagesat e transaksioneve të brendshme dhe ndërkombëtare për të siguruar furnizimin e rregullt me valutë për përmbushjen e nevojave të ekonomisë së Kosovës në konsultim me autoritetet kompetente qeveritare.

PASQYRAT FINANCIARE, KONTROLLI FINANCIAR DHE RAPORTET

Neni 52
Viti financiar i BQK-së

Viti financiar i BQK-së fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 53
Praktikat e kontabilitetit

53.1 BQK-ja mban llogaritë dhe regjistrimet për veprimet dhe gjendjen financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

53.2 Bilanci dhe deklaratat e tjera financiare të BQK-së përfshijnë llogaritë e veçanta të rezervës së përgjithshme; rezervat për mbulimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta dhe amortizimin e aktiveve.

Neni 54 Deklaratat financiare

BQK-ja përgatitë deklaratë financiare për çdo vit financiar. Ato përfshijnë bilancin, deklaratën e fitimeve dhe të humbjeve dhe deklaratat lidhur me to.

Neni 55 Kontrolli i pavarur i llogarive financiare të BQK-së

Llogaritë, regjistrimet dhe deklaratat financiare kontrollohen nga ekspertë të pavarur të kontabilitetit të njohur ndërkombëtarisht e të rekomanduar nga Bordi drejtues dhe të miratuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit. Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit mund të shkarkojë ekspertët e pavarur të kontabilitetit të BQK-së për arsye të bazuara mirë. I njëjti kontrollor i pavarur financiar nuk mund të angazhohet për më shumë se pesë vjet radhazi.

Neni 56 Përcjellja dhe botimi i deklaratave dhe raporteve

56.1 Brenda gjashtë muajve pas mbylljes së çdo viti financiar, BQK-ja i dorëzon Kuvendit dhe Qeverisë si në vijim:

- a) deklaratat financiare të vërtetuara nga ekspertët e jashtëm të kontabilitetit;
- b) raportin për veprimtarinë dhe punët gjatë atij viti; dhe
- c) raportin për gjendjen ekonomike.

56.2 BQK-ja përgatitë sa më shpejtë që të jetë e mundur pas ditës së fundit të punës së çdo tremujori, por në çdo rast pas brenda 15 ditë pune një përmbledhje të deklaratave financiare të tremujorit të fundit.

56.3 Me plotësimin e tyre BQK-ja publikon deklaratat dhe raportet financiare të përshkruara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, nëse e sheh të arsyeshme mund të botojë edhe raporte e studime të tjera për çështje financiare dhe ekonomike.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 57

Konsultime rreth propozimeve rregullatore

Qeveria dhe Kuvendi konsultohen me BQK-në për çdo propozim lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me objektivat e BQK-së ose që janë në kompetencë të saj para se propozimet të marrin formën e prerë.

Neni 58

E drejta e përparësisë e BQK-së

58.1 BQK-ja gëzon të drejtën e përparësisë së pakushtëzuar për përmbushjen e të gjitha pretendimeve të saj nga çdo llogari në para të gatshme dhe aktivë tjetër që ai mban për llogari të tij apo për llogarinë e huamarrësit në fjalë në kohën kur ky pretendim maturohet dhe bëhet i pagueshëm, qoftë si peng për të siguruar pretendimet e veta ose në mënyrë tjetër.

58.2 BQK-ja mund të ushtrojë të drejtën e përparësisë vetëm duke mbajtur llogari në para të gatshme dhe duke shitur aktivet e tjera me çmim të arsyeshëm dhe duke paguar vetën prej të ardhurave nga shitja pas zbritjes së shpenzimeve të shitjes. Për ushtrimin e së drejtës së përparësisë nga BQK-ja nuk kërkohet asnjë veprim gjyqësor dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni nuk lejohet asnjë pretendim konkurrues të vonojë ushtrimin e kësaj të drejte, madje as kërkesat për pronësi ose të drejtat e fituara më parë derisa të mos ketë prova të qarta dhe bindëse se punonjësit e BQK-së e kanë ditur apo konsiderohet se duhej ta dinin në kohën e vënies së aktivave në pronësi të BQK-së që ato nuk i përkasin huamarrësit në fjalë.

Neni 59

Veprimet e ndaluara të BQK-së

59.1 Përveç rasteve kur specifikisht parashihet ndryshe përmes këtij ligji ose ndonjë ligji apo akti nënligjor pasues, BQK-ja:

- a) nuk jep kredi, nuk mban depozita dhe nuk jep dhurata në para apo dhurata financiare;
- b) nuk angazhohet në tregtim, blerje të aksioneve të ndonjë korporate apo kompanie, duke përfshirë edhe aksionet e ndonjë institucioni financiar, ose në interesa të pronësisë në sipërmarrje financiare, tregtare, bujqësore industriale apo në ndonjë sipërmarrje tjetër apo
- c) nuk fiton nga blerja, qiraja ose e drejta në pasuri të patundshme, përveç kur ai e sheh të nevojshme a të dobishme në sigurimin e lokaleve për udhëheqjen e punëve administrative apo për strehimin e punonjësve të tij ose për kërkesa të tjera të ngjashme detyësore për kryerjen e funksioneve të tij sipas dispozitave të këtij ligji .

59.2 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e këtij ligji , BQK-ja mund:

- a) të japë hua, të posedojë aksione ose të jetë pjesëmarrëse e ndonjë organizate që është e angazhuar në aktivitete që kërkohen për kryerjen e duhur të funksioneve ose përgjegjësi të BQK-së;
- b) të përfitojë për shlyerjen e borxheve ndaj saj çfarëdo interesi apo të drejte të përmendur në pikën (b) të paragrafit 1 të këtij neni, me kusht që të gjitha këto interesa ose të drejta të përfituara në këtë mënyrë të jepen me rastin e parë të mundshëm;
- c) t'u jep kredi punonjësve të vet për këto qëllime në shuma, afate dhe kushte të përcaktuara prej tij me kusht që shumat e këtyre kredive të hiqen nga llogaritë e kapitalit ose
- d) të caktojë taksa të arsyeshme sipas parimit të paanshmërisë konkurruese për shërbime që i ofron:
 - (i) si pronar apo operator i sistemeve të pagesës, kliringut dhe të shlyerjes së borxheve;
 - (ii) si mbikëqyrës i institucioneve financiare, i tregtarëve me valuta të huaja, i tregtarëve ndërmjetësues dhe i fondeve të përbashkëta dhe
 - (iii) si ofrues i menaxhimit të valutave.

Neni 60

Grumbullimi i informatave statistikore

60.1 BQK-ja grumbullon informacionin e nevojshëm statistikor për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të tij dhe për këtë qëllim mund të angazhohet në bashkëpunim teknik me autoritetet kompetente jashtë Kosovës. BQK-ja mund të shqiptojë dënime ndaj institucioneve financiare nëse ka pasur shkelje të rënda dhe të përsëritura të rregullave mbi të dhënat statistikore të BQK-së.

60.2 BQK-ja përcakton informacionin e nevojshëm statistikor dhe mënyrën sipas së cilës ky informacion i dërgohet BQK-së, personat që duhet të sjellin këtë informacion në BQK dhe ruajtjen e konfidencialitetit që zbatohen për informacionin statistikor të dhënë në BQK.

60.3 BQK-ja kontribuon në harmonizimin e rregullave dhe praktikave për administrimin e mbledhjes, përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore brenda kuadrit të kompetencave të tij.

Neni 61

Përfshirja e BQK-së nga tatimi i përgjithshëm në të hyra

BQK-ja përfshihet nga tatimi i përgjithshëm në të hyra.

Neni 62

Kompetencat rregullatore dhe të inspektimit të BQK-së

62.1 BQK-ja ka kompetenca për të nxjerrë rregulla, urdhëresa apo udhëzime për të vizituar zyrat e institucioneve financiare, për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe regjistrimet e tjera, për të ndërmarrë veprime të tilla që BQK-ja i gjykon si të nevojshme apo të këshillueshme për të zbatuar dispozitat e këtij ligji.

62.2 Të gjitha rregullat, urdhëresat dhe udhëzimet e nxjerra nga BQK-ja që janë të zbatueshme për më shumë se një institucion financiar duhet të botohen dhe hyjnë në fuqi në datën e botimit apo në një datë të mëvonshme që mund të caktohet në vetë direktivën, urdhëresën ose udhëzimin. BQK-ja mban një regjistër publik për këto rregulla, direktiva dhe udhëzime.

62.3 Rregullat dhe urdhëresat e BQK-së janë vendime përfundimtare në procedurat administrative.

Neni 63

Standardet e administrimit të mirë

63.1 BQK-ja në përputhje me praktikat e shëndosha administrative zbaton kompetencat e dhëna nga ky ligj në mënyrë të barabartë dhe të njëtrajtshme. BQK-ja duhet të përmbahet nga përdorimi i këtyre kompetencave në shërbim të ndonjë objekti që është jashtë këtyre kompetencave të dhëna ose që tejkalon atë që kërkohet për arritjen e objektivit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

63.2 vendimet e BQK-së të marra në përputhje me këtë ligj duhet të jenë të paanshme dhe të motivuara vetëm nga konsiderata objektive dhe racionale; këto vendime do të përmbahen me ndershmëri dhe maturi.

Neni 64

Llogaritë e mirëbesimit

BQK-ja autorizohet të hapë dhe të mbajë librat, llogaritë, aktivet dhe detyrimet e të cilave duhet veçuar nga aktivet dhe pasivet e tjera. Aktivet e çdo llogarie të tillë vihen në dispozicion vetëm për plotësimin e pasiveve të asaj llogarie dhe asnjë aktiv tjetër i BQK-së nuk vihet në dispozicion për të plotësuar pasivet e kësaj llogarie.

Neni 65
Praktikat e punësimit

BQK-ja zbaton politikë jodiskriminuese të punësimit në mënyrë që përbërja e punonjësve të pasqyrojë natyrën shumetnike të bashkësive në Kosovë.

Neni 66
Shqyrtimet gjyqësore

Në çfarëdo procedure gjyqësore apo të arbitrazhit që ngrihet lidhur me këtë ligj kundër BQK-së apo ndonjë zyrtari, nëpunësi apo agjenti të BQK:

- a) e vetmja pyetje para gjyqit apo gjyqit të arbitrazhit në përcaktimin nëse i pandehuri ka vepruar kundër ligjit është nëse i pandehuri ka vepruar me mospërfillje flagrante apo me veprime apo lëshime të tilla të cilat përbëjnë sjellje të paligjshme me dashje, duke ditur faktet dhe ligjin ose rregullat, urdhëresat dhe udhëzimet e nxjerra;
- b) një administrator, punonjës apo agjent i BQK-së nuk mund të jetë përgjegjës për dëmet, veprimet apo mosveprimet e bëra gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, përveç kur këto veprime ose mosveprime përbëjnë mospërfillje flagrante apo sjellje të gabuar me dashje dhe
- c) veprimi në fjalë do të vazhdojë pa kufizime gjatë periudhës së një ankimi dhe çdo ankimi të mëtejshëm apo procedurave të tjera gjyqësore lidhur me ankimin; dhe
- d) BQK do ti mbulojë shpenzimet e bëra për mbrojtjen ligjore të të punësuarve të sajë të cilët, përderisa kanë kryer detyrat e tyre për BQK me ndershmëri, dhe nuk është gjetur asnjë mospërfillje flagrante apo veprime apo lëshime të tilla të cilat përbëjnë sjellje të paligjshme me dashje.

Neni 67
Shfuqizimi

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/47 shfuqizohet.

Neni 68
Ligji në fuqi

Ky Ligj shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 69
Dispozitat kalimtare

Këshilli drejtues që do të emërohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij Ligji i cili do të përbëhet nga anëtarët ekzistues të Këshillit drejtues që vazhdon në mënyrë retroaktive nga data e mandatit paraprak. Çfarëdo propozime apo emërime pasuese të cilat i bëhen Këshillit Drejtues do të bëhet në pajtim me Nenin 18.2 të këtij Ligji.

Neni 70
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë (15) pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-074
5 qershor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI